



"QENDRA KOMBETARE  
TERAPEUTIKE DHE  
REHABILITUESE PER FEMIJET"

Nr. 565 prot., dt. 10/05/2023

Nr. 34 prot., d. 26/05/2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI  
NDËRMJET  
UNIVERSITETIT "BARLETI"  
DHE  
"QENDRES KOMBETARE  
TERAPEUTIKE DHE REHABILITUESE PER FEMIJET"

**Preambul:** Universiteti "Barleti" i përfaqësuar nga Prof. Dr. Suzana Guxholli dhe "Qendra Kombetare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët" (QKTRF), e përfaqësuar nga Dr. Florida Dobi, në vijim të quajtura Palë:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit arsimor në kuadër të modernizimit të tij;

Duke marrë në konsideratë politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra për funksionimin dhe përmirësimin e një sistemi arsimor profesional të përgjegjshëm dhe modern për t'u përshtatur kushteve të zhvillimeve sociale, për përmirësimin shërbimit mjekesor dhe social për fëmijet e moshes 0-6 vjec;

Duke inkurajuar angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta në veprimtarinë dhe etikën e të gjitha hallkave të sistemit arsimor;

Duke konsideruar se një ndër objektivat kyçë në ushtrimin e veprimtarise së sistemit arsimor është efikasiteti dhe eficienca e administratës arsimore të këtij Universiteti në perputhje me standarde dhe praktikat me të mira vendase dhe ato perëndimore;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkepunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje për të përmbrushur edhe angazhimet në kuadër të Integrimit Evropian të sistemit arsimor në fushën e shërbimit social;

Duke u mbështetur ne kuadrin ligjor qe rregullon veprimtarine institucionale, konkretisht, ne Ligjin nr. 80/2015, date 22.07.2015, "Per Arsimin e Larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise"

dhe ne Ligjin nr. Nr.10/107, datë 30.03.2009 "Per kujdesin Shendetosor ne Republiken e Shqiperise";

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, sipas termave të dakortesuara ne vijim:

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyja palëve dhe mbetet në fuqi për 3 vjet nga data e firmosjes.

Me përfundimin e afatit, nëse asnë nga palët nuk shpreh vullnetin për t'i dhënë fund, kjo marrëveshje rinovalitet automatikisht në mënyrë të heshtur për një afat tjeter 3 vjeçar.

**Neni 5**  
**Vlerësimi i zbatimit te Marrëveshjes**

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë zbatimin e marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në perfundim të çdo viti akademik.
2. Raporti përban, krahas të dhënave për ecurine e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjate një viti akademik edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara. Raporti publikohet në faqet zyrtare të Paleve.
3. Të dy institucionet bien dakort që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potentialit të disponueshëm nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme dhe ndjekja e zbatimit do të realizohet nga një përfaqësues i ngarkuar nga secili institucion.

**Neni 6**  
**Komunikimi midis palëve**

1. Palët, angazhohen të mbajne një komunikim të vazhdueshëm ndermjet tyre dhe të shkëmbjnë qdo informacion të nevojshem për permëbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në forme shkresore, ose në rrugë elektronike. Në qdo rast të paraqitjes së një kërkese, palët angazhohen të japid per gjigje brenda 10 diteve.
2. Palët angazhohen të janë të disponueshme në qdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmernen rast pas rasti.

**Neni 7**  
**Dispozita të fundit**

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me mirëkuptim ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Cdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në qdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.
3. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej palëve, sjell si pasojë përfundimin e ligjshmërisë së saj.
4. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga pala që e kërkon, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.

5. Nëse njëri prej institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara. Mosrinovimi i kësaj marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, tekstet e saj janë autentike dhe secila palë mban nga 2 (dy) kopje.

Nënshkruar në Tiranë, më 26.05. 2023.

REKTORI  
I UNIVERSITETIT "BARLETI"

PROF. DR. SUZANA GUXHOLI



DREJTORI I QENDRËS  
KOMBETARE TERAPEUTIKE  
DHE REHABILITUESE PER FEMIJET

DR. FLORIDA DOBI

